



Portali informativ

infokomuna

lidhje direkte me komunën tuaj...



LANSIMI I BULETINIT “MUJORI I KOMUNAVE”

RAPORT

18 Tetor, 2016

Lansimi i Buletinit “Mujori i Komunave”

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe portali INFOKOMUNA lansuan numrin e parë të buletinit “Mujori i Komunave” i cili pasi cili pasqyron kronologjinë e ngjarjeve dhe aktiviteteve për 30 ditë të shtatorit 2016. Në këtë ngjarje morën pjesë zyrtarët për informim nga komunat e Kosovës, përfshirë komunat serbe dhe partnerët (DEMOS).

“Mujori i Komunave”, përveç si mënyrë e pasqyrimit të punës së komunave, njëkohësisht shërben si formë e shkëmbimit të përvojave dhe mjet i adresimit dhe avokimit të komunave tek institucionet qeveritare dhe akterët tjerë që angazhohen dhe operojnë në, ose së bashku me nivelin lokal.

Në këtë ngjarje u prezantuan edhe disa nga gjetjet të cilat janë identifikuar gjatë procesit të punës në buletin dhe në portalin INFOKOMUNA. Krahasuar me vitin 2015, raportimi i komunave dhe komunikimi me publikun është përmirësuar jo vetëm lidhur me aktivitetet e komunës dhe kryetarit të komunës, por edhe organizatave të ndryshme që operojnë në Kosovë, mirëpo komunat ende vazhdojnë të ballafaqohen me sfida lidhur me këtë çështje.

Ndërkaq, sa i përket transparencës, edhe pse ka lëvizje të mirë, Instituti KLGJ dhe portali INFOKOMUNA kanë vërejtur probleme serioze të cilat paraqiten në vijim:



- *Ueb faqet e Komunave të Kosovës* - Ka problem serioz me standardizimin e ueb faqeve të komunave si në përmbajtje, ashtu edhe në estetikë.

- *Dokumentet; Përdorimi i logove dhe dokumenteve* - Ky problem vjen si rrjedhojë e mungesës së një udhëzuesi për përdorimin e ueb faqeve nga komunat.

- *Rrjetet Sociale; "Facebook"* - Problemi qëndron tek ajo se ka dublikim mes faqes së kryetarit të komunës, komunës dhe aktiviteteve që përçohen përmes rrjetit social Facebook. Ende ekziston një qasje ad-hoc dhe vetëm e vullnetit të këtyre zyrave, pa ndonjë platformë ose udhëzim për përdorim. Si rezultat, porosia e aktiviteteve dhe ngjarjeve nga komunat devijon, andaj, vihet në pyetje transparenca e komunave ndaj qytetarëve. Për pasojë, efekti i komunikimit, transparenca dhe llogaridhënia paraqesin problem. Tek rrjetet sociale ende ekziston një qasje ad-hoc dhe vetëm e vullnetit të këtyre zyrave, pa ndonjë platformë ose udhëzim për përdorim
- *Salla e Konferencave:*. Ka probleme serioze në dhënien e efektit të duhur të këtyre takimeve, andaj këto takime duhet të bëhen më funksionale. Një problem tjetër qëndron edhe te zyret për komunikim pasi që ka mungesë të një stafi përcjellës të cilët ndihmojnë që porosia dhe transparenca të jenë më të sakta.

Për më tepër, disa nga problemet me të cilat ballafaqohen zyret për informim janë:

- Mungesa e Stafit;
- Mungesa e Pajisjeve të duhura për përcimin e mesazheve të aktiviteteve;
- Mos-buxhetimi;
- Mungesa e trajnimeve lidhur me metodat e reja dhe moderne të komunikimit.

Ndërkaq gjatë prezantimit të Mujori i Komunave” u theksua se ky buletin është dokument i përgjithësuar që përmbledh aktivitetet dhe ngjarjet e komunave të Kosovës. Informacionet dhe lajmet e paraqitura në buletin janë marrë nga faqet zyrtare të komunave të Kosovës.



Rubrikat e Buletinit “Mujori i Komunave”:

- Performancë e shtuar
- Kryetarët në teren
- Bashkëpunim – Koordinim
- Mbështetje për Komunat
- Bashkëpunim me Shoqërinë Civile
- Problemi i Muajit
- Organizatat me fokus komunat
- Inovacione
- Qytetari Aktiv i Komunës
- Ngjarja e Muajit
- Çmimi për Demokraci Lokale
- Ngjarje – Aktivitete
- Rajoni në lëvizje
- Përkrahja nga Qendra
- Promovimi, Zhvillimi Ekonomik dhe Mirëqenia
- Përfshirja e qytetarëve në vendim-marrje
- Shërbimet cilësore

Në buletin “Mujori i Komunave” paraqiten aktivitete për secilin kryetar komune duke u fokusuar në lajme më të rëndësishme. Po ashtu, ky dokument do të shërbejë si mjet për shkëmbimin e përvojave, ku do të mundësohet bartja e iniciativave dhe praktikave të mira ndërmjet komunave dhe si mjet i adresimit dhe avokimit të komunave tek institucionet qeveritare dhe akterët tjerë që angazhohen dhe operojnë në, ose së bashku me nivelin lokal.

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale dhe Portali INFOKOMUNA, në koordinim me komunat dhe ministrinë sektoriale, do të angazhohen në hartimin e udhëzuesit për standardizim dhe komunikim efektiv me synimin për të ngritur kapacitetet profesionale dhe koordinuese të zyrave për marrëdhënie me publikun. Kjo do të arrihet duke u bazuar në praktikat rajonale dhe trendet ndërkombëtare të komunikimit, transparencës dhe llogaridhënies.

Kosovo Local Government Institute (KLG I)
E-mail: info@klgi-ks.com | ueb: www.klgi-ks.com



Portali INFOKOMUNA
lajme@infokomuna.com | www.infokomuna.com



*Rruga "Musine Kokolari" nr. 20, 10000
Prishtinë, Republika e Kosovës*